

PASQYRAT FINANCIARE TË SHOQËRISË

« AUTO EKSPRES »SHPK

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E PERFORMANCËS	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	4
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	5-16

AUTO EKSPRES sh.p.k
(Vlerat janë në Lek)
**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2015**

	Shënime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	1,772,343	496,885
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	8,596,832	2,797,146
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	1,419	551,042
Inventarë	7	13,490,738	16,306,280
Total aktive afatshkurtra		23,861,332	20,151,353
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	1,008,587	1,222,265
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	9	100,000	100,000
Total aktive afatgjata		1,108,587	1,322,265
Total aktive		24,969,919	21,473,618
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	10	6,184,520	4,862,593
Llogari të pagueshme tregtare	11	2,013,065	4,092,358
Detyrime tatimore	12	607,009	302,610
Total detyrime afatshkurtra		8,804,594	9,257,561
Detyrime afatgjata			
Total detyrime afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve		8,804,594	9,257,561
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar		100,000	100,000
Rezerva ligjore		649,205	478,401
Fitime të mbartura		11,466,852	8,221,558
Fitimi i ushtrimit		3,949,268	3,416,098
Total kapitali	13	16,165,325	12,216,057
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		24,969,919	21,473,618

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

AUTO EKSPRES sh.p.k

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	14	67,504,636	92,449,322
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	15	98,500	(94,443)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shërbime		(59,614,474)	(86,000,304)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme, shërbime dhe shpenzime			
1) të tjera	16	(57,471,354)	(84,408,127)
2) Të tjera shpenzime	17	(2,143,120)	(1,592,177)
Shpenzime te personelit	18	(2,785,044)	(2,562,732)
1) Paga dhe shpërblime		(2,386,500)	(2,196,000)
Shpenzime të sigurimeve			
2) shoqërore/shëndetësore		(398,544)	(366,732)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8	(255,574)	(253,122)
Zhvlerësim i aktiveve financiare dhe investimeve të mbajtura si aktive afatshkurtra		-	-
Shpenzime financiare	19	(117,238)	520,975
Shpenzime interesi dhe shpenzime të			
1) ngjashme		(117,238)	520,975
2) Shpenzime të tjera financiare		-	-
Fitimi/humbja para tatimit		4,830,806	4,059,696
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	20	(881,538)	(643,598)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(881,538)	(643,598)
Fitimi/humbja e vitit		3,949,268	3,416,098
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		3,949,268	3,416,098

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

AUTO EKSPRES sh.p.k


(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitet	Totali
Pozicioni më 1 janar 2014	100,000	179,108	-	2,534,998	5,985,853	8,799,959
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:					3,416,098	3,416,098
Transferim në rezervë ligjore		299,293			(299,293)	-
Transferim në fitime të mbartura			5,686,560		(5,686,560)	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2014	100,000	478,401	-	8,221,558	3,416,098	12,216,057
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:					3,949,268	3,949,268
Transferim në rezervë ligjore		170,804			(170,804)	-
Transferim në fitime të mbartura			3,245,294		(3,245,294)	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2015	100,000	649,205	-	11,466,852	3,949,268	16,165,325

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë aprovuar nga administratori i Auto Ekspres më _____ dhe janë firmosur si më poshtë.


Z. Besnik Bimi
 Administrator




Znj. Albana Hoxha
 Drejtuese e Financës

AUTO EKSPRES sh.p.k
(Vlerat janë në Lek)
**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	3,949,268	3,416,098
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:	-	
Shpenzimet financiare jomonetare	257,697	553,893
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	577,856	
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	255,574	253,122
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(5,827,919)	3,759,295
Rënie/(rritje) në inventarë	2,815,542	2,560,984
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(1,774,894)	(10,808,705)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	253,124	(265,313)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(41,896)	(490,000)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(41,896)	(490,000)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të arkëtuara	1,321,927	1,444,681
Interes i paguar	(369,216)	(471,663)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	952,711	973,018
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	1,163,939	217,705
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	496,885	361,410
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	111,519	(82,230)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	1,772,343	496,885

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

“Auto Ekspres” sh.p.k është themeluar më 14.07.2011 si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe është e regjistruar në Regjistrin tregtar me NIPT L11914003U.

Veprimtaria kryesore e shoqërisë për vitin ushtrimor ka qënë ngritja e një aktiviteti tregtar e shërbimesh si: riparim për të gjitha llojet e markave të automjeteve; importimi i të gjitha llojeve të automjeteve dhe të markave; shitja me shumicë dhe pakicë e pjesevë të këmbimit, gomave, nyjeve servis universal për të gjitha llojet e automjeteve, qiradhënie e automjeteve etj.

Ortaku i vetëm i shoqërisë është Z. Besnik Bimi, i cili zotëron një kapital prej 100,000 lek, i ndarë në 100 kuota (1,000 Lek/secila).

Administrator i shoqërisë është Z. Besnik Bimi.

Shoqëria gjatë vitit 2015 ka pasur 4 punonjës (2014 :3 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrit nr.64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2015	2014
Euro/Lek	137.28	140.14
USD/ Lek	125.79	115.23

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2015 dhe 2014 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20 %
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20 %
Instrumenta dhe vegla pune	Vlera e mbetur	20 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre dhe lidhjes që ato kanë me ushtrimin e mbyllur kontabël, pavarësisht nëse arkëtimi i tyre apo i një pjese prej tyre do të ndodhë në një ushtrim pasardhës.

Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto (pa TVSH dhe zbritjet tregtare), të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësishme ekonomike raportuese, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitaleve të veta.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetëm qira operative.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdoj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Mjete monetare në bankë	1,626,589	493,972
Mjete monetare në arkë	145,754	2,913
	<u>1,772,343</u>	<u>496,885</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Klientë për fatura të pranuar	8,596,832	2,797,146
	<u>8,596,832</u>	<u>2,797,146</u>

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Tatimi mbi fitimin		551,042
Mbipagesa në Doganë	1,419	
	<u>1,419</u>	<u>551,042</u>

7. Inventarë

Gjendja e inventarit paraqitet si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Pjesë këmbimi	13,490,738	16,306,280
	<u>13,490,738</u>	<u>16,306,280</u>

AUTO EKSPRES sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

8. Aktive Afatgjata Materiale

	Mobilje dhe orendi	Pajisje informatike	Makineri dhe pajisje	Automjete	Të tjera	Totali
Kosto						
Gjendja më 1 janar 2014	8,000	210,763	-	1,260,000	10,500	1,489,263
Shtesa			490,000			490,000
Nxjerrje jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 dhjetor 2014	8,000	210,763	490,000	1,260,000	10,500	1,979,263
Shtesa		41,896				41,896
Nxjerrje jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 dhjetor 2015	8,000	252,659	490,000	1,260,000	10,500	2,021,159
Amortizimi i akumuluar						
Gjendja më 1 janar 2014	(2,586)	(77,930)	-	(420,000)	(3,360)	(503,876)
Amortizimi i vitit	(1,082)	(33,208)	(49,403)	(168,000)	(1,429)	(253,122)
Nxjerrje jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 dhjetor 2014	(3,668)	(111,138)	(49,403)	(588,000)	(4,789)	(756,998)
Amortizimi i vitit	(866)	(31,047)	(88,118)	(134,400)	(1,143)	(255,574)
Nxjerrje jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 dhjetor 2015	(4,534)	(142,185)	(137,521)	(722,400)	(5,932)	(1,012,572)
<i>Vlera neto kontabël</i>						
Gjendja më 31 dhjetor 2014	4,332	99,625	440,597	672,000	5,711	1,222,265
Gjendja më 31 dhjetor 2015	3,466	110,474	352,479	537,600	4,568	1,008,587

9. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Kapital i nënshkruar por i papaguar nga Ortaku i Vetëm	100,000	100,000
	<u>100,000</u>	<u>100,000</u>

10. Hua afatshkurtra

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Overdraft Veneto Bank	6,184,520	4,515,768
Hua të tjera afatshkurtra	-	346,825
	<u>6,184,520</u>	<u>4,862,593</u>

11. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Furnitorë	2,013,065	4,092,358
	<u>2,013,065</u>	<u>4,092,358</u>

12. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
TVSH për t'u paguar	501,470	239,463
Tatim mbi fitimin	26,814	
Tatim mbi të ardhurat personale	14,381	12,090
Kontribute për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore	64,344	51,057
	<u>607,009</u>	<u>302,610</u>

13. Kapitali

	<u>31 dhjetor 2015</u>			<u>31 dhjetor 2014</u>		
	Kuotat	Vlera nominale	%	Kuotat	Vlera nominale	%
Z. Besnik Bimi	100	1,000	100%	100	1,000	100%
	<u>100</u>	<u>1,000</u>	<u>100%</u>	<u>100</u>	<u>1,000</u>	<u>100%</u>

14. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Te ardhura nga pjesët e këmbimit	56,518,055	42,192,657
Të ardhura nga shitja e makinave	10,253,184	50,190,248
Të ardhura nga riparimet dhe montimet	733,397	66,417
	<u>67,504,636</u>	<u>92,449,322</u>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Qarkullim i tatueshëm	67,504,636	92,316,322
Amortizimi i të ardhurave në avancë	-	133,000
Shtohen diferencat e kursit që përfshihen në zërin të ardhura të tjera	98,500	(94,443)
Shuma e qarkullimit e korrektuar	67,603,136	92,354,879
Sipas Kontabilitetit	67,603,136	92,354,879
Diferenca	<u>-</u>	<u>-</u>

15. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Humbje nga këmbimet valutore	(39,899)	(116,082)
Të ardhura nga këmbimet valutore	138,399	21,639
	<u>98,500</u>	<u>(94,443)</u>

16. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme dhe shërbime

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Shpenzime për blerjen e makinave	10,136,524	49,874,550
Shpenzime për blerjen e pjesëve të këmbimit	46,291,770	33,382,002
Shpenzime për qiranë e magazinave	841,500	842,500
Shpenzime për riparimin e makinave	193,122	301,664
Taksa automjetesh	8,438	7,411
	<u>57,471,354</u>	<u>84,408,127</u>

17. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Shpenzime administrative	375,306	319,495
Shpenzime sigurimi	34,555	30,350
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	110,772	104,906
Shpenzime udhëtimi, dieta	-	66,780
Shpenzime reklame	135,485	41,768
Shpenzime bankare	357,252	391,852
Shpenzime të tjera	25,453	376,049
Shpenzime fotokopje dhe noterizime	15,300	9,900
Shpenzime për shërbime konsulence	50,000	-
Shpenzime të pazbritshme	1,018,877	230,957
Taksa dhe tarifa vendore	20,120	20,120
	<u>2,143,120</u>	<u>1,592,177</u>

18. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Shpenzime për paga	2,386,500	2,196,000
Shpenzime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	398,544	366,732
	<u>2,785,044</u>	<u>2,562,732</u>

19. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet dhe të ardhurat nga interesat. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Të ardhura nga interesat	251,978	992,638
Shpenzime për interesa	(369,216)	(471,663)
	<u>(117,238)</u>	<u>520,975</u>

20. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Fitimi para tatimit	4,830,806	4,059,696
<i>Shpenzime të panjohura të tjera</i>	<u>1,046,116</u>	<u>230,957</u>
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	5,876,922	4,290,653
Tatim fitimi @15%	<u>881,538</u>	<u>643,598</u>
Fitimi i vitit	<u>3,949,268</u>	<u>3,416,098</u>

21. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyrafinanciare.